



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 17.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Infra Plus**”sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “**Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët “ , Nr. i prokurimit- 632-22-11133-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-123-211.,** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**Infra Plus**”sh.p.k, e dt.21.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët “ , Nr. i prokurimit- 632-22-11133-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-123-211,** kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 17.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.

2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** të publikuar me datë 17.10.2022, në platformën elektronike të KRPP-së;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.21.10.2022, Operatori Ekonomik “**Infra Plus**”sh.p.k.,ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “**Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët “ , Nr. i prokurimit- 632-22-11133-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-123-211.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 26.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pa bazuar, sepse kërkesa në FDT e AK që në staf të jetë i përfshirë një Inxhinier i Diplomuar ose Master i Arkitekturës - me përvojë pune profesionale në trashëgimi (i licensuar për Restaurim dhe Konservim), është kërkuar për shkak se AK do të kërkon projekte të infrastrukturës në zonat e trashëgimisë kulturore, sipas pikës 14 seksioni B të paramasës, po ashtu Ministira e Kulturës dhe organet e saj kërkojnë që projektet e infrastrukturës në zonat e trashëgimisë të projektohen nga arkitekt të cilët kanë licencë për restaurim dhe konservim. Komuna e Gjakovës ka zona të trashëgimisë kulturore të cilat janë të mbrojtura me ligjet përkatëse.

Pra, kontraktuesi duhet të ketë në staf një inxhinier të tillë në mënyrë që të plotësohen kriteret për projektim të infrastrukturës në zonat e trashëgimisë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës